

EDVIN STEFANI



Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit në KLSH

Lindur më 1975. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(1998). Doktor i Shkencave Ekonomike.

15 vite eksperiencë pune. Në 13 vite lektor pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës.

Prej më shumë se 2 vjet, Kryeauditues dhe Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit në KLSH. Fusha e ekspertizës: Analiza e riskut dhe sistemi fiskal.

KRIZA FINANCIARE DHE PASOJAT E SAJ NË SHQIPËRIⁱⁱⁱ

nga Edvin Stefani

Krizat dhe goditjet e ekonomive nuk janë fenomen i ri dhe i panjohur, për më tepër ato janë pjesë shoqëruese e vetë ekonomisë së tregut, e cila në shumë raste i gjeneron ato në mënyrë thuajse ciklike. Historia e ekonomisë botërore është e mbushur me të tilla. I njeh praktika dhe teoria ekonomike, që është munduar të japë dhe rrugëzgjdhje. Duke iu referuar studimeve të kërkuesve të ndryshëm lidhur me krizat financiare, edhe në rastet kur krizat nuk vijnë nga probleme në sistemin bankar, ato kanë një efekt të konsiderueshëm në sistemin bankar. Nga këto studime është e qartë që krizat financiare ndikojnë ekonominë në mënyra të ndryshme. Në ekonominë e zhvilluara, efekti dhe pasojat e këtyre krizave janë të kufizuara. Krizat financiare kanë qenë gjithmonë pjesë e pandarë dhe janë të lidhura me zhvillimin ekonomik. Sipas historisë, shumë vende të zhvilluara të tilla si SH.B.A, Angli dhe vende të tjera kanë përjetuar kriza financiare kryesisht për shkak të panikut bankar. Këto lloje krizash vijnë natyrshëm me zhvillimin e ekonomisë dhe besimin te

detyrimet e bankës. Dalja prej tyre është ndihmuar nga veprime të brendshme të vetë bankave por edhe nga ndërhyrjet e bankave qëndrore. Sic tregohet në këtë temë, krizat financiare që kanë goditur vendet në tranzicion, megjithëse janë të ndryshme në natyrën e tyre, janë shkaktuar nga të njëjtit faktorë dhe efektet e tyre janë pothuajse të njëjta. Një faktorë tjerët kryesor i krizave financiare është përcaktuar edhe mungesa e stabilitetit politik.

Kriza e tanishme e quajtur e Wall Street-it apo dhe kriza financiare në fakt është edhe më e gjerë nga sa emërtohet. Ajo ka prekur pjesë të tëra të ekonomisë botërore dhe është më komplekse, e shtrirë në kohë dhe në hapësirë. Nuk ka prekur vetëm SHBA, ku vetëm industria financiare përbën 22% të PBB së ekonomisë amerikane, por edhe Evropën e Azinë. Ka disa vite që troket në derën e ekonomisë botërore dhe mendohet të vijojë së paku dhe vitin tjetër dhe më fort në Evropë. Është shumëplanëshe sepse është e fokusuar në sektorin financiar, më saktë akoma në atë të kredive hipotekore në tregun e shtëpive, por ka prekur edhe pjesën tjetër të ekonomisë (qeveritë, bankat, fondet e investimeve, kompani të sigurimeve, fonde të pensioneve, korporatat dhe individët, që kanë investuar paratë e kursimet e tyre në letrat me vlerë të emetuara nga institucionet e fuqishme financiare amerikane). Efekti do të jetë zinxhir. Kështu parashikime të njëpasnjëshme japin shifra gjithnjë në ulje të rritjes ekonomike globale. Referuar krizës së fundit, kjo krizë vuri “nën zgjedhë” shtete me PBB shumë herë më të lartë se Shqipëria. Mos harrojmë që eksperiencia ka provuar që krizat bankare shpesh paraprihen nga bumet e kreditit. Nga ana tjetër, në shumicën e rasteve fillimi i bumeve të kreditit vjen nga derregullimi ose liberalizimi financiar (vendet Nordike në 1990). Për një vend që ka shkuar në krizë, me përkufizim, bum krediti konsiderohet çdo proces kreditimi, kur rritja mesatare e kredisë private ndaj PBB-së në tre vitet para krizës është mbi 10% në vit.

Duhet patur parasysh që Europa preku recesionin, gjë që nënkupton rritje të inflacionit dhe të papunësisë në të ardhmen. Kjo do krijojë probleme edhe për vendin tonë.

Dhe pse sistemi bankar shqiptar duket i shëndetshëm, likuid, me fitime dhe i kapitalizuar mirë, ndikime përsëri do ketë, pasi bankat e huaja mund të kufizojnë financimin e filialeve apo degëve të tyre në Shqipëri dhe për rrjedhojë do kufizohet edhe kreditimi i bizneseve dhe individëve në vend. Ndërsa në vendet e huaja kompanitë e biznesi financohen vec bankave edhe në tregun e letrave me vlerë kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto mundësi në Shqipëri nuk ekzistojnë. Prandaj një kufizim dhe shtrenjtim i kredisë bankare do ketë implikime negative të menjëhershme në kontraktimin e biznesit shqiptar. Nga ana e tyre, tkurrja e kreditimit dhe kufizimi i riskut do ndikojë në uljen e fitimeve të sistemit bankar në Shqipëri dhe kuptohet potencialisht dhe në uljen e rritjes ekonomike të vendit. Aktivitetet totale të sistemit bankar e tejkalojnë 60% të PBB-së në vend.

Edhe pse jo në situatë krize, është e rëndësishme për vendin që të nxjerrë mësim nga eksperiencat e vendeve që kanë përjetuar dhe po kalojnë kriza. Përvoja tregon se sa më e vonuar të jetë ndërhyrja dhe kundërpërgjigjia nga autoritetet, aq më e lartë do jetë kostoja që do përballojë vendi.

Kriza shqiptare

Situata jo e mirë ekonomike që pritet për një numër të konsiderueshëm të ekonomive më të mëdha botërore, sigurisht që përbën një risk potencial edhe për ecurinë ekonomike Shqipëri.

Dy arsye kryesore për këtë përqasje janë: (i) studimet empirike dhe eksperiencat e vendeve të tjera të ngjashme tregojnë qartë për një efektivitet më të lartë në rastet kur përdoren instrumentat e shpenzimeve të politikës fiskale se ato të taksave; (ii) gjatë dy - tre viteve të fundit të gjitha taksat

kryesore (përvec TVSH) janë përgjysmuar duke mos lënë hapsirë efektive për reduktimin e mëtejshëm të tyre. Por gjithsesi duhet theksuar që reduktimi i këtyre taksave ka relativisht një kohë të shkurtër që është bërë (ulja e nivelit të disa prej taksave është bërë vjet) e si rrjedhojë pritet që edhe për të paktën vitet në vijim të ndjehen në mënyrë domethënëse efektet pozitive të tyre në ekonomi, duke dhënë kështu një impakt shtesë në sheshimin e efekteve negative të krizës ndërkombëtare në ekonomi.

Zgjatja në kohë dhe përkeqësimi i mundshëm i situatës në tregjet financiare ndërkombëtare, mund të kenë një ndikim të reduktuar në tregun bankar dhe atë financiar shqiptar. Për rrjedhojë rekomandohet që:

- 1- Politikat dhe sistemet e brendshme të vlerësimit të rrezikut duhet të mbështesin vendimmarrjen e institucioneve bankare në drejtim të orientimit të tyre drejt aktiviteteve dhe sektorëve me rrezik të ulët.
- 2- Institucionet financiare jobankare dhe bankat, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre, duhet të monitorojnë përqëndrimin e produkteve të tyre sipas sektorëve të ekonomisë duke synuar shpërndarjen sa më të ekuilibruar të veprimtarisë dhe shmangien e përqëndrimeve ndaj sektorëve të ekonomisë që ndikohen negativisht nga rënia e ekonomisë rajonale dhe globale.
- 3- Bankat duhet të kufizojnë kredidhënien ndaj agjentëve ekonomik në monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën ato gjenerojnë të ardhurat e tyre. Kjo pasi karakteristikat e rrezikut që mbart huadhënia e shpejtë dhe posaçërisht ajo në valutë, si rezultat i rritjes së luhatshmërisë së kursit të këmbimit dhe ndryshimit të shpeshtë të normave të interesit rrit ekspozimin e bankës ndaj rrezikut të moskthimit të kredisë dhe gërryen rezultatin financiar të saj.
- 4- Situata e pritshme në përkeqësim të krizës ekonomike në Europë në vitin që vjen imponon jo më mbajtjen e një marrëveshje rutinë me autoritetet e

vendit mëmë, por njohje reale të gjendjes dhe të ecurisë së pritshme të aktivitetit të bankës mëmë dhe kontakte intensive mes mbikëqyrësve profesionistë.

5- Banka e Shqipërisë duhet të marrë në analizë kërkesë-ofertën për ndërtime, të parashikojë nëse ka mbivlerësime të çmimeve për pasuritë e patundshme dhe të parashikojë ku pritët të shkojë tregu duke orientuar dhe bankat. Bumi i ndërtimeve i stimuluar dhe nga kreditë për shtëpi mund të jetë afër fundit, pasi kredia do vijë e do bëhet gjithnjë e më e shtërnguar si nga rregullat e Bankës së Shqipërisë ashtu edhe nga vetë masat prudente të bankave të huaja që operojnë në vend. Ato do e bëjnë kredinë më të shtrenjtë dhe më të vështirë.

6- Tregu bankar dhe ai financiar nevojitet të ndërtohet dhe zhvillohet paralelisht me sistemin ligjor. Nuk mund të ketë transaksione financiare vendase apo ndërkufitare, nëse nuk ka siguri në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave kontraktore. Aktualisht, kolaterali tek ne ka probleme. Kolaterali duhet vlerësuar më seriozisht: nga ndonjë ndikim në çmimet e ardhshme të shtëpive, për probleme pamundësie ekzekutimi të shitjes nga mungesa e tregut, për shkaqe të rregjistrimit të parregullt, tregu ynë nuk është treg likuid, njihen problemet me përmbarimin etj.

7- Statistikat duhet të jenë cilësore, transparente, në kohë dhe të besueshme. Sidomos në raste krizash duhet një publik që kupton ç'po ndodh dhe beson te autoritetet e për më tepër bashkërendon me to, kurrsesi një publik i panjohur me fenomenin dhe që vepron në panik.

8- Nevojitet rishikimi i skemës së sigurimit të depozitave, skemë e cila gjykohet e kufizuar dhe rrit riskun e quajtur “arbitrazh rregullator”. Në një kohë pasigurie e klime paniku, ekziston rreziku i largimit të fluksit të depozitave në valutë në drejtim të vendeve fqinjë (Greqi, Itali), si dhe shumë

prej vendeve të botës ku ka shqiptarë emigrantë ku kufiri i sigurimit të depozitave është rritur.

9- Bankat tregtare ne Shqiperi, në veprimtarinë e tyre praktike të përditshme duhet të shtojnë vëmendjen dhe kujdesin në punën me klientët e tyre, pasi çdo nënvleftësim apo neglizhencë e nënpunësve të bankës keqinterpretohet dhe krijohen mendime negative pa asnjë bazë.

10- Mund të shihet mundësia e rritjes së rezervave valutore për të përballuar një goditje të papritur të monedhës nga nënçmimi për të kufizuar dëmet në ekonomi.

ⁱ Botuar në Gazetën “Telegraf” dt. 15 Korrik 2013

ⁱⁱ Botuar me disa shkurtime nga origjinali.